



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9095 Prot.

Lezhë, më 05 . 05 .2021

VENDIM

Nr. 91 Datë 30 . 04 . 2021

Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.630/26, datë 09.04.2021 “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit shoqëror në bashki” dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit me World Vision Albania, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një shtese dhe ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2021, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 4,141,612 lekë.

2/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” në shumën 4,141,612 lekë. Veprimet të kryhen në:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 për shumën 2,931,572 lekë.
- Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.600 për shumën 279,089 lekë.
- Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.601 për shumën 55,951 lekë.
- Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.231 për shumën 875,000 lekë (Blerje automjeti).

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

